

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5801
E premte, 14 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Mbyllen 29 motele në Kosovë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**NË BURGUN
E NISHIT
DËGJUEM NË
LAJME SE
LUFTA NË
KOSOVË KA
MBARUAR** F. 11



SADIK ZEQRIRI

AKTUALE

**KUVENDI I SHOIPËRISË,
REZOLUTË KUNDËR METËS
PËR ZGJEDHJET
E 30 QERSHORIT** F. 2

**ÇEKIA DO TA MBËSHITESË
ANËTARËSIMIN E KOSOVËS
NË INTERPOL** F. 3

EKONOMI

**REÇICA NË LUKSEMBURG
PREZANTON REFORMAT E
NDËRMARRA NGA MPMS-ja** F. 9

**OAK-u DHE DELEGACIONI NGA
KONGO DISKUTOJNË PËR
MUNDËSITË E EKSPORTIT TË
PRODUKTEVE TË KOSOVËS** F. 8

SPORT

**TË SHTUNËN NË STADIUMIN
'FADIL VOKRRI' NDESHJA
E YJEVE GRANIT XHAKA
DHE MILOT RASHICA** F. 14



FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM KRASNIQI | FAQE 4-5

Palët në Shqipëri po duan të përfitojnë politikisht nga kriza, jo ta zgjidhin atë



Politologu Afrim Krasniqi ka thënë se tejkalimit të krizës në Shqipëri mund t'i kontribuojë krijimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe formimi i një qeverie teknike në prag të zgjedhjeve parlamentare. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se presidenti, qeveria dhe opozita më shumë po mendojnë të përfitojnë politikisht nga kriza sesa ta zgjidhin atë. Sipas Krasniqit, presidenti nuk mund të rrëzohet për shkak se kjo procedurë kërkon të pak-

tën deri në dy muaj kohë. Ai ka thënë se PS-ja e ka të qartë se shkarkimi i presidentit më shumë e dëmton sesa e ndihmon atë dhe krizën në vend. Krasniqi ka theksuar se nuk pret zgjidhje nga partitë dhe politikanët që janë burim i krizave

Thaçi: Forca e Sigurisë është e mishëruar për ta mbrojtur paqen



Në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, në cilësinë e komandantit suprem, ka inspektuar ushtarët e Kosovës. Me këtë rast ai u është adresuar atyre, duke thënë se Kosova është krenare me profesionalizmin e kësaj force. Shefi i shtetit ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës është e mishëruar me dëshirën për liri dhe me gatishmërinë për ta mbrojtur paqen për çdo qytetar të Kosovës, në çdo cep të vendit

Nënshkruhet protokoli për marrëveshjen e ekstradimit në mes të Kosovës dhe ShBA-së



FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kuvendi miraton me 100 vota rezolutën kundër Presidentit Meta

Kuvendi i Shqipërisë ka votuar rezolutën kundër Presidentit të Republikës Ilir Meta si një hap drejt vendimit të maxhorancës për të shkarkuar kreun e Shtetit. Ky vendim i artikulluar qartë nga maxhoranca erdhi pas dekretit të Presidentit për anulimin e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit.

100 deputetë votuan pro rezolutës, 2 abstenim, 7 kundër dhe 1 pa votuar, çka do të thotë 30 deputetë më shumë se grupi parlamentar i PS-së.

Parlamenti zhvilloi sot mocion me debat për rreth 5 orë rresht pikërisht për çështjen e Presidentit, ndërsa në fund u votua rezoluta "Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit Nr. 10928, datë 05.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore". Ndërkohë Kreu i Kuvendit njoftoi se seanca e radhës do të jetë të hënën, 17 qershor ora 10:00.



Në rezolutë tashmë të miratuar nga Parlamenti, maxhoranca e konsideron dekretin për anulimin e zgjedhjeve të 30 qershorit, një akt të paprecedentë që synon të mohojë realizimin e së drejtës kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur për-

faqësuesit e tyre në pushtetin vendor.

"Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Presidentit të Republikës të reflektojë duke kthyer institucionin e Presidentit në kufijtë e kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe të mos ndër-

rmarrë asnjë veprim tjetër në shkelje flagrante të Kushtetutës", thuhet në draft rezolutë.

"Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se akti i Presidentit datë 10.06.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 "Për caktimin e datës

së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", është një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kapërcim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit të Presidentit dhe si i tillë ai konsiderohet nul dhe sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Kuvendi i Shqipërisë mbështet qëndrimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për vijimin e procesit zgjedhor dhe inkurajon këtë organ të vijojë të mbrojë pacënueshmërinë si dhe të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019 nisur si rrjedhojë e zbatimit të Dekretit të Presidentit nr. 10928, datë 05.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", duke e njohur këtë të fundit si të vetmin akt të ligjshëm të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019", citohet në rezolutë.

Basha e quan teatër përpjekjen e Ramës për shkarkimin e Metës

Kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, e ka cilësuar si teatër përpjekjen e Edi Ramës për shkarkimin e presidentit Ilir Meta. Sipas tij gjithë kjo bëhet për të larguar vëmendjen e shqiptarëve nga situata e krijuar prej Edi Ramës dhe se ky proces do të përfundojë një përfundim për atë.

"Edi Rama kërkon të shfokusojë

vëmendjen e opinionit publik për situatën e krijuar prej tij. Mos kini asnjë iluzion se farsa e sotme përfundoi në rezolutë dhe po konsumon orët e pasdites për tu shndërruar në një pendim të Edi Ramës, nuk është gjë tjetër, veçse teatër i Edi Ramës, sepse e ka nevojë jetike që të ju largojë vëmendjen nga kjo situatë e krijuar prej tij. Ka

nevojë ta largojë vëmendjen nga fakti që është kapur duke vjedhur votat, pasuritë tuaja publike, për t'ia dhënë një grushti njerëzish që ka ardhur në pushtet".

"Gjatë 48 orëve të fundit, shuam miq kanë kërkuar të mbizotërojnë arsyeja dhe interesi i shqiptarëve dhe Edi Rama t'i hapë rrugë një procesi politike, që kërkon asgjë

më pak se sa një proces standard zgjedhesh. Sfidimi i hapur që Edi Rama bën, përpjekja për të vendosur 30 qershorin në qendër të debatit politik, kur tani 30 qershori nuk ka vlerë ligjore, por vetëm politike. Orët dhe ditët e ardhshme, do të caktojnë se si do të jetë Shqipëria në 10-15 vitet e ardhshme", ka thënë Basha.



Gara e kandidatëve demokratë presidencialë në Ajova bëhet më e fortë

WASHINGTON, 13 QERSHOR - Shteti qendror i Ajovas është fokusi i garës për Shtëpinë e Bardhë në vitin 2020, prandaj kandidatët e shumtë demokratë që kërkojnë emërimin e partisë së tyre po bëjnë fushatë në 99 distriktet e tij. Ata po përpiqen t'i përmirësojnë shanset e tyre para debateve të kësaj vere. Nga sallat e valëzimit tek ato të birrës, fushata për emërimin e kandidatit të partisë demokrate ka filluar në shtetin e Ajovas.

Objektivi i kandidatëve të shumtë është një temë, ose më saktë një person: Donald Trump. Por, përpara se ta sfidojnë presidentin Trump në zgjedhjet e përgjithshme të nëntorit 2020, kandidatët duhet ta fitojnë mbështetjen e demokratëve të



Ajovas, si Michael Ryan. Ajova është gara e parë në fillim të vitit 2020, ku votuesit zgjedhin kandidatin demokrat që do ta sfidojë Trumpin.

"Jam gati për dikë të ri që ta marrë këtë rol", thotë ai. Kjo është arsyeja që ai po mbështet kryebashkiakun 37-vjeçar të qytetit South Bend të

Indianës, Pete Buttigieg, i pari kandidat kryesor presidencial homoseksual. "Sepse është i ri, elokuent dhe sjell risi", tha ai. "Mendoj se gratë duhet të jenë të përfaqësuar", thotë Beverly Hannon, ish-senatore e Shtetit të Ajovas. "Unë u zgjodha në vitin 1984 në grupin demokrat të Senatit të Ajovas. Isha e vetmja grua mes 29 burrave", tha ajo. Ajo thotë se është e inkurajuar nga numri rekord i grave që po kandidojnë nga garën presidenciale demokrate. Por ajo mbështet senatorin e Vermontit, Bernie Sanders, që identifikohet si socialist demokrat. "Mendoj se është skandalozë që nuk kemi kujdes shëndetësor universal dhe kjo është një nga arsyet që na pëlqen Bernie", tha Hannon.

Për votuesen nga Cedar Rapids, Teresa Kyle, ka vetëm një çështje me rëndësi në 2020-ën. "Rroga minimale duhet të jetë 15 dollarë". Ajo beson se ish-nënpresidenti Joe Biden, që kryeson garën në anketat e hershme, është kandidati më i mirë për ta plotësuar një gjë të tillë. "Ai po lufton për rrogën minimale dhe shpresojmë edhe për strehimin", tha ajo.

Ndërsa votuesit e partisë demokrate të Ajovas janë të ndarë lidhur me kandidatin që duhet të zgjedhë partia e tyre, shumica thonë se në fund të fundit do ta mbështesin atë që do të emërohet dhe janë të bashkuar në kundërshtimin e tyre ndaj presidentit Trump. "Mendoj se Donald Trump ka

qenë një katastrofë për vendin", thotë Beverly Hannon.

"Vërtet do të doja që të ktheheshim në pikën ku të ishte dikush më i respektueshëm në Shtëpinë e Bardhë, që e respekton presidencën, që punon për të gjithë, që nuk shan njerëzit", thotë Michael Ryan.

Ruga për në Shtëpinë e Bardhë kalon nga Ajova për demokratët, me zgjedhjet më 3 shkurt 2020, ku votuesit do ta zgjedhin kandidatin e tyre, por cilido që të fitojë mes demokratëve, do të përballë me një betejë të vështirë në kutitë e votimit në zgjedhjet e përgjithshme në nëntor 2020 në Ajova, një shtet i lëkundur ku presidenti Trump dhe republikanët fituan bindshëm në zgjedhjet e vitit 2016.

Me rastin e 20-vjetorit të lirisë, presidenti Hashim Thaçi ka inspektuar ushtarët e Kosovës

Thaçi: Forca e Sigurisë është e mishëruar për ta mbrojtur paqen

Në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, në cilësinë e komandantit suprem, ka inspektuar ushtarët e Kosovës. Me këtë rast ai u është adresuar atyre, duke thënë se Kosova është krenare me profesionalizmin e kësaj force. Shefi i shtetit ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës është e mishëruar me dëshirën për liri dhe me gatishmërinë për ta mbrojtur paqen për çdo qytetar të Kosovës, në çdo cep të vendit

**EPOKA
ERE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është e mishëruar me dëshirën për liri dhe me gatishmërinë për ta mbrojtur paqen. Në inspektimin e ushtrisë, me rastin e 20-vjetorit të lirisë, komandanti suprem i FSK-së është shprehur krenar me profesionalizmin e ushtrisë së Kosovës. "Të nderuar ushtarë, nga aspirata dhe angazhimi i popullit për liri keni lindur edhe ju. E kishim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e transformuan në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, e themeluam Forcën e Sigurisë së Kosovës, para pak muajsh

morëm edhe vendimin historik për themelimin e ushtrisë së Kosovës. Gëzuar juve dhe vlerësime më të lartë për punën tuaj personale. Forca e Sigurisë së Kosovës është e mishëruar me këtë dëshirë për liri me gatishmërinë për ta mbrojtur paqen për çdo qytetar të Kosovës, në çdo kënd të Kosovës", ka thënë Thaçi.

Ai ka thënë se këto ditë që po shënohet 20-vjetori i lirisë dhe përfundimi i gjenocidit e spastrimit etnik të shtetit të Serbisë, Kosova me respekt kujton të gjithë ata që sakrifkuan për këtë ditë. "Këto ditë po shënojmë 20-vjetorin e lirisë së vendit dhe popullit tonë. Sot kujtojmë të gjithë dëshmorët e lirisë, luftëtarët trima të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës. Kujtojmë me nderime dhe respekt komandantin legjendar Adem Jashari. Kujtojmë me nderime dhe respekt sakrificën e çdo qytetari të Kosovës që në një formë apo formën tjetër që kudo që jetonin ishin shndërruar në çlirimtarë të Kosovës", ka thënë Thaçi, duke shtuar se këto ditë po shënohet

20-vjetori i mbylljes së kapitullit të tragjediave për popullin e Kosovës. "Shënojmë 20-vjetorin e kthimit të një milion qytetarëve të Kosovës në shtëpitë e tyre në Kosovë, vazhdimin e rindërtimit të jetëve dhe të shtëpive tona, mbylljen e kapitullit të tragjediave e vuajtjeve dhe hapjen e kapitullit të shpresës dhe angazhimit për një jetë më të mirë", është shprehur presidenti Thaçi.

Para ushtarëve të Kosovës, kreu i shtetit ka deklaruar se kjo forcë është ndërtuar sipas standardeve të NATO-s. "Forca e Sigurisë së Kosovës sot është forcë profesionale e standardeve të NATO-s, forcë shumetnike, që në mënyrën më të mirë pasqyron atë që kemi arritur Kosovën që e kemi ndërtuar së bashku. Këto ditë kujtojmë të kaluarën, por shikojmë edhe kah e ardhmja. Kemi arritur shumë në këta 20 vjet. Kemi pasur sfida jo të lehta, kemi ndërtuar institucionet e shtetit dhe kemi rindërtuar shoqërinë. Kemi vënë bazat e zhvillimit ekonomik dhe të sundimit të ligjit", ka thënë presidenti Thaçi.

Ai ka bërë me dije se institucionet e Kosovës janë duke punuar për anëtarësim në NATO dhe BE. Por, sipas tij, kjo rrugë nuk do të jetë e lehtë dhe as e shkurtër. "Rruga nuk do të jetë e lehtë dhe as e shpejtë. Duhet të përfundojmë reformat në ekonomi, në drejtësi dhe në politikë. Duhet ta përmbylim konsolidimin ndërkombëtar të shtetit, duke fituar anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Kemi ndërtuar marrëdhënie të mira me fqinjët tanë, me Shqipërinë, me Malin e Zi dhe me Maqedoninë Veriore", ka thënë ai, duke përmendur edhe procesin e dialogut me Serbinë. "Po punojmë për marrëveshje paqësore, finale, gjithëpërfshirëse, ligjërish të obligueshme, me Serbinë. Dëshirojmë t'i mbyllim kapitujt e konfliktit dhe tragjediave të shekujve të kaluar. Ta hapim kapitullin e shekullit të ri, të jetës në liri, në barazi, në zhvillim dhe prosperitet. Kjo është aspirata jonë e përbashkët. Kjo është detyra jonë. Ky është zotimi ynë për qytetarët e Kosovës. E gëzofshim lirinë!", ka përfunduar Thaçi.



Limaj takon drejtoreshën e BE-së për Ballkanin, flasin për dialogun dhe vizat

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh bashkëkryesues i Delegacionit Shtetëror për Bisedime me Serbinë, ka pritur të enjten në takim drejtoreshën e BE-së për Evropën Perëndimore, Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Angelina Eichhorst. Limaj ka njoftuar se me zrytaren e lartë të BE-së kanë bise-

duar për zhvillimet aktuale politike në vend, dialogun Kosovë - Serbi dhe proceset integruese të Kosovës. "Ishte konstatim i përbashkët që dialogu mes dy vendeve është i paalternativë dhe duhet të gjejmë rrugë për të rifilluar dialogun, në mënyrë që të arrijmë një marrëveshje gjithëpërfshirëse obligative për njohje reciproke", ka thënë Limaj pas takimit.



Flet për "Epokën e re", Afrim Krasniqi

Palët në Shqipëri po duan të përfitojnë



Politologu Afrim Krasniqi ka thënë se tejkalimit të krizës në Shqipëri mund t'i kontribuojë krijimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe formimi i një qeverie teknike në prag të zgjedhjeve parlamentare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se presidenti, qeveria dhe opozita më shumë po mendojnë të përfitojnë politikisht nga kriza sesa ta zgjidhin atë. Sipas Krasniqit, presidenti nuk mund të rrëzohet për shkak se kjo procedurë kërkon të paktën deri në dy muaj kohë. Ai ka thënë se PS-ja e ka të qartë se shkarkimi i presidentit më shumë e dëmton sesa e ndihmon atë dhe krizën në vend. Krasniqi ka theksuar se nuk pret zgjidhje nga partitë dhe politikanët që janë burim i krizave

askush, përfshirë Kuvendin, nuk ka të drejtë të vendosë nëse dekreti përbën shkelje dhe nëse data mbetet. Vendimi nga KQZ-ja për mosnjohjen e tij është sa absurd aq edhe joproduktiv për vetë integritetin e zgjedhjeve. Nga ana tjetër, arsyetimit të dekretit i mungoi platforma dhe propozimi se si mund të shkohet te zgjidhja", ka theksuar ai. Sipas Krasniqit, presidenti nuk do të mund të rrëzohet për shkak se kjo procedurë kërkon të paktën një muaj e gjysmë deri në dy muaj kohë kalendarike dhe në fund kërkon vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk është funksionale deri në shtator. "PS-ja po përdor retorikë shkarkimi për të bërë presion dhe për ta ushqyer politikën e ditës, por e ka të qartë se shkarkimi i presidentit më shumë e dëmton sesa e ndihmon atë dhe krizën në vend", ka deklaruar Krasniqi.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike në Shqipëri, konkretisht rreth shfuqizimit të dekretit për zgjedhjet e 30 qer-

shorit nga ana e presidentit Meta dhe këmbëngulësisë së kryeministrit Rama që zgjedhjet lokale të mbahen me këtë datë?

Krasniqi: Akti i presidentit për datën e zgjedhjeve është më shumë akt politik sesa presidencial. Formalisht Kushtetuta nuk e njeh këtë kompetencë por, nga ana tjetër, kreu i shtetit nuk mund të qëndrojë pasiv nëse vendi hyn në një spirale krize politike. Në mungesë të Gjykatës Kushtetuese askush, përfshirë Kuvendin, nuk ka të drejtë të vendosë nëse dekreti përbën shkelje dhe nëse data mbetet. Vendimi nga KQZ-ja për mosnjohjen e tij është sa absurd aq edhe jo produktiv për vetë integritetin e zgjedhjeve. Nga ana tjetër, arsyetimit të dekretit i mungoi platforma dhe propozimi se si mund të shkohet te zgjidhja. Nuk ka ende një platformë bisedimesh e dialogu politik dhe duket se presidenti, qeveria dhe opozita më shumë po mendojnë të përfitojnë politikisht nga kriza sesa ta zgjidhin atë. Qoftë anulimi i datës, qoftë protestat pa objektiv të qartë, qoftë edhe këmbëngulja

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Drejtori i Institutit të Studimeve Politike, politologu Afrim Krasniqi, ka thënë të enjten se çelësi i zgjedhjes së krizës në Shqipëri mund të jetë krijimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe se nisja e hetimeve serioze për politikanët e korrumpuar që në Shqipëri kanë edhe pozita të larta drejtuese në secilën parti politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

deklaruar se zgjidhje mund të jetë edhe përvoja maqedonase dhe greke për qeveri teknike në prag të zgjedhjeve parlamentare, afimi i zgjedhjeve parlamentare më 2020, si dhe reformimi i plotë i sistemit zgjedhor dhe i legjislacionit mbi partitë politike. "Pa këto masa çdo kompromis tjetër është afatshkurtër dhe burim për krizën e radhës", është shprehur Krasniqi. Sipas tij, presidenti, qeveria dhe opozita më shumë po mendojnë të përfitojnë politikisht nga kriza sesa ta zgjidhin atë. "Qoftë anulimi i datës, qoftë protestat pa objektiv të qartë,

qoftë edhe këmbëngulja e kryeministrit për të bërë zgjedhje me një kandidat dhe vetëm me anëtarët e partisë së tij, nuk e zgjidhin krizën dhe as nuk tregojnë lider-ship, seriozitet dhe përgjegjshmëri", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se akti i presidentit për datën e zgjedhjeve është më shumë akt politik sesa presidencial. Megjithatë, ai ka theksuar se formalisht Kushtetuta nuk e njeh këtë kompetencë por, nga ana tjetër, kreu i shtetit nuk mund të qëndrojë pasiv nëse vendi hyn në një spirale krize politike. "Në mungesë të Gjykatës Kushtetuese

politikisht nga kriza, jo ta zgjidhin atë

e kryeministrit për të bërë zgjedhje me një kandidat dhe vetëm me anëtarët e partisë së tij, nuk e zgjidhin krizën dhe as nuk tregojnë lidhshmëri, seriozitet dhe përgjegjshmëri.

"Epoka e re": Pas qëndrimit të palëkundur të Metës, se Kushtetuta do të mbrohet deri në fund, PS-ja ka nisur proceduarat për shkarkimin e tij. A mund t'i sigurojë PS-ja votat për shkarkimin e Metës nga posti i presidentit?

Krasniqi: Jo. Procedura e shkarkimit të presidentit kërkon të paktën një muaj e gjysmë deri në dy muaj kohë kalendarike dhe në fund kërkon vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk është funksionale aktualisht dhe deri në shtator. PS-ja po përdor retorikë shkarkimi për të bërë presion dhe për ta ushqyer politikën e ditës, por e ka të qartë se shkarkimi i presidentit më shumë e dëmton sesa e ndihmon atë dhe krizën në vend. Nga ana tjetër, vetë presidenti duket se më rehat ndihet në pozitën e udhëheqësit politik në LSI sesa në zyrën e presidentit. E gjithë kjo është një paradoks dhe një tregues sesa joseriozë janë politikanët në Shqipëri dhe sesa klienteliste dhe e personalizuar është jeta politike dhe institucionale këtu.

"Epoka e re": A mendoni se në këtë situatë do të duhej që të ketë një angazhim më të madh të faktorit ndërkombëtar në Tiranë, që palët të arrijnë pajtim për një datë të zgjedhjeve?

Krasniqi: Kjo është kriza më me

pak ndërmjetësime ndërkombëtare në dy dekadat e fundit. Ka tri arsye për këtë: e para, është krizë unike sepse opozita nuk është pjesë e jetës institucionale në parlament dhe se një parti qeveris e vetme vendin. Arsyeja e dytë është se koha ka treguar se të njëjtit liderë politikë e kanë përdorur presionin e negociimit ndërkombëtar jo për të zgjidhur e parandaluar kriza, por për të bërë marrëveshje të personalizuara midis tyre, siç ka ndodhur më 2007, 2008, 2012, 2015, 2017. Ndaj ndërkombëtarët nuk duan të përdoren më nga liderit tanë lokalë. Arsyeja e tretë është diferenca në këndvështrime midis kancelarive kryesore ndërkombëtare ndaj Shqipërisë. Ka vende që kërkojnë stabilitet me çdo çmim, pra mbështetje qeverisë dhe mazhorancës, ka vende që kërkojnë hapa pas për secilën palë dhe më shumë demokraci funksionale. Palët në Shqipëri po përdorin diferenca të tilla për të gjetur alibi mbështetëse. Nga ana tjetër, BE-ja ka prioritete të tjera dhe disa vende kritike ndaj Shqipërisë e kanë më të lehtë ta arsyetojnë votën e tyre kundër me vetë zhvillimet që po u dhurojmë nga Tirana.

"Epoka e re": Si e shihni ju rrjedhën e këtyre ngjarjeve?

Krasniqi: Unë mendoj se çelësi i ndryshimit do të jetë krijimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe nisja e hetimeve serioze për politikanët e korrumpuar që në Shqipëri kanë edhe pozita ta larta drejtuese në secilën parti poli-

tike. Po ashtu, zgjidhje mund të jetë përvoja maqedonase dhe greke për qeveri teknike në prag të zgjedhjeve parlamentare, afri-mi i zgjedhjeve parlamentare më 2020, si dhe reformimi i plotë i sistemit zgjedhor dhe i legjislacionit mbi partitë politike. Pa këto masa çdo kompromis tjetër është afatshkurtër dhe burim për krizën e radhës. Në çdo rast një pakt i tillë afatgjatë për reforma dhe integrim duhet ta marrë në konsideratë modelin italian të ca viteve më parë për kufizimin e mundësive që lideri kryesor politik ta mbajë postin e kryeministrit, një zgjidhje që ka mbështetje të gjerë te qytetarët shqiptarë dhe që kërkon presion edhe më të madh nga Brukseli, Uashingtoni dhe Berlina.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, PD-ja ka mbajtur disa protesta kundër qeverisjes së Edi Ramës. A janë të drejta këto protesta, edhe pse përfaqësuesit ndërkombëtarë në Tiranë i kanë kundërshtuar për mënyrën se si kanë përfunduar, duke përjashtuar dy prej tyre që kanë qenë më paqësore?

Krasniqi: Opozita ka disa kërkesa të drejta dhe faktet publike ia legjitimojnë retorikën e tyre, sidomos rastet flagrante të trafikut të votës apo lidhjeve midis politikës e krimin të organizuar. Por, nga ana tjetër, opozita gaboi kur dorëzoi apriori mandatet pa plan B dhe kur, midis nevojës për zgjerim të mbështetjes qytetare në vend dhe ndërkombëtare në lobim, zgjedhi të fokusohet në bazën e saj militante dhe në ecjen në drejtim të kundërt nga këshillat

perëndimore. Tani që sjellja e saj është fakt, ajo duhet të jetë e gatshme të tregojë se do t'i bëjë të njëjtat sakrificat që ia kërkon edhe palës tjetër, duke filluar nga heqja dorë e synimit për ta ndryshuar qeverinë pa ndryshuar sistemin korrupsiv politik, si dhe ofrimi i një modeli të ri qeverisës më demokratik, më transparent, më llogaridhënies dhe më legjitim, ofertë që mund të kërkojë reformim të thellë të vetë lidhshmërisë të opozitës dhe ndryshim të elitave e mentaliteteve drejtuese brenda saj.

"Epoka e re": Si e shihni të ardhmen politike të PS-së, PD-së dhe LSI-së?

Krasniqi: Nuk pres zgjidhje nga parti apo politikanë që janë burim i krizave. Këto parti kanë nevojë për reformim të thellë, për profilizim dhe për demokratizim, pra për t'u bërë realisht 'parti politike' sipas konceptit kushtetues dhe evropian, për kalim nga modele klienteliste në funksion të liderit apo rrethit mbështetës të tij në alternativa reale demokratike. Ato kanë nevojë edhe për më shumë konkurrencë, në radhë të parë duke krijuar mundësinë që qytetarët të zgjedhin vetë deputetët e presidentin dhe që në Shqipëri të ketë hapësirë për prurje të reja politike. Nëse kjo nuk ndodh dhe tri partitë vijojnë të jenë të tilla në koncept e funksion, kriza e fundit nuk do të jetë e fundit dhe se progresi demokratik do të ketë stanjacion shumë më të gjatë sesa 2-5 apo 7 vjetët e ardhshëm.

Çekia do ta mbështesë anëtarësimin e Kosovës në Interpol

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, është duke qëndruar për një vizitë dyditore në Çeki. Pacolli të enjten është prituri në takim nga ministri i Jashtëm i Çekisë, Tomas Petricek. Pacolli dhe Petricek në këtë takim kanë biseduar për thellimin e marrëdhënieve diplomatike dhe për ndërtimin e një partneriteti gjithëpërfshirës me theks në zhvillimin ekonomik dhe të investimeve.

Ministri Pacolli ka ngritur çështjen e zhvillimit të Kosovës në rajonin e Ballkanit Perëndimor, mënyrat e bashkëpunimit për të ndërtuar të ardhmen në BE. Ndërsa ministri Petricek ka për-

shëndetur të arriturat e Republikës së Kosovës dhe është zotuar për mbështetjen e shtetit të Kosovës në proceset integruese. Gjithashtu, ai ka mirëpritur punën e bërë për përbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara për Kosovën në liberalizim të vizave.

Ministri Petricek ka bërë me dije se Çekia do ta mbështesë Kosovën në procesin e anëtarësimin në Interpol ashtu siç ka bërë edhe në të kaluarën. Në fund të këtij takimi të dy ministrat janë pajtuar se duhet thellim i marrëdhënieve mes dy vendeve në të gjitha fushat. Ministri Pacolli e ka ftuar për vizitë zyrtare në Kosovë homologun e vet çek për t'i parë nga afër përparimet që janë bërë ndër vite.



Autori francez promovon në Prishtinë librin kushtuar presidentit Thaçi

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Është promovuar të enjten në Prishtinë libri "Lindja e një demokracie: Hashim Thaçi dhe rruga drejt pavarësisë së Kosovës" i autorit Jacques Baudouin. Ky libër tashmë është edhe në gjuhën shqipe. Nuri Behxheti, recensent i këtij libri, ka thënë se vëmendja më e madhe në këtë libër i kushtohet kryeministrit të parë të Kosovës së pasluftës, Hashim Thaçit. "Kemi zgjedhur për ju një libër të veçantë që në qendër të vëmendjes ka një vend dhe personazh. Vëmendjen më të madhe në narracionin tonë ia kushton Kosovës personazhi kryesor, këtë meritë ia atribuon autori presidentit Hashim Thaçit", ka thënë ai. Behxheti ka bërë me dije se origjinali i këtij libri është i shkruar në gjuhën frënge, derisa ka treguar edhe disa detaje të tjera. "Origjinali është shkruar në gjuhën frënge. Libri është i ndarë në 20 kapituj voluminozë. Hyn në kategorinë e librave që lexohet për dy ditë e një natë. Koha tregoi që ai pati të drejtë me mbështetësit e tij në rrugën për liri", është shprehur Behxheti, duke shtuar se autori i librit në fjalë sjell intriga, shantazhe e



shumëçka tjetër. Ndërsa profesor Ibrahim Gashi ka thënë se autori i këtij libri në mënyrë kompetente hedh dritë mbi atë se në çfarë ka kaluar Kosova. Ndërkaq Daan Everts, ish-shëf i misionit të OSBE-së, ka thënë se gjithmonë duhet kujtuar e kalu-

ara në Kosovë. "Është e jashtëzakonshme të jem në këtë ndërtesë unike. 20 vjet më parë gjithçka ishte e shkatërruar, nuk kishte profesorë e fakultete. Është kënaqësi të shoh se si kanë arritur të funksionalizohen. Është shumë me rëndësi që të

shkruhet për atë kohë, të mos harrohet. Po ta shikosh Kosovën pas lufte dhe të krahasosh me ato të tjerat që kanë dalë prej luftës, Kosova është shumë më mirë. Libri tregon detaje që as unë nuk i kam ditur", është shprehur ai.

Krejt në fund, autori i këtij libri "Lindja e një demokracie: Hashim Thaçi dhe rruga drejt pavarësisë së Kosovës", Jacques Baudouin, ka thënë se për të bërë një shtet të së drejtës, duhet të luftohet për të drejtën. Ai ka thënë se këtë libër e ka bërë për lexuesin francez, për t'u njohur me vuajtjet e shqiptarëve. "Ju mund të pyetni se pse një francez ka dy vjet që po shfaqet me këtë aventurë për të përkrahur këtë luftë, vuajtjet e një populli. Unë, në fakt, nuk jam historian. Një shkrimtar kërkon të kuptojë dhe kërkon të shohë se çka fshihet pas, kushtimisht prapa perdeve. Unë këtë libër e kam bërë për lexuesit francezë, sepse e kanë një problem të vërtetë, i harrojnë të gjitha. Thaçi është vizionar, mendon për fëmijët. Është shumë e rëndësishme për Evropën të ketë një burrështetas të atillë, të cilin e duam apo jo, një pjesë e paqes në Evropë, është mbi Kosovën dhe nën kraharorin e z. Thaçi. Nuk është një kompliment falas që po ia atribuoj, por jam objektiv", ka thënë Baudouini, duke shtuar se Kosova është një vend i paqes dhe demokracisë.

Besnik Tahiri në Ankara prezanton reformat në qeverisje

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në Forumin e parë të Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore që u mbajt në Ankara të Turqisë, me temën "Ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse".

Në hyrje të prezantimit të tij, Tahiri ka paraqitur një rezymenë për Republikën e Kosovës, shtetin më të ri, që këtë vit feston 20-vjetorin e çlirimit, ndaljes së represionit, vrasjeve dhe spastrimit etnik nga regjimi i Millosheviqit. Ai në këtë forum ka shprehur mirënjohje dhe falën-



derim për të gjitha ato vende që kanë mbështetur lirinë dhe shtetndërtimin për Kosovën. Gjithashtu, ka theksuar përparimin e arritur si shtet dhe si

shoqëri në të gjitha dimensionet. Në kuadrin e ndërtimit të institucioneve efektive, të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse, po ashtu

ka pasqyruar reformat e ndërmarra në pakon ligjore në administratën publike, funksionimin më efikas të qeverisë (përmes Projektligjit për qeverinë), përmirësimin e ambientit të të bërit biznes përmes uljes së barrierave (përmes Projektligjit për Inspektimet), si dhe rezultatet e arritura në politikëbërjen në qeveri, të vlerësuara tashmë edhe nga raportet e Bankës Botërore.

Tahiri pas kthimit nga Ankaraja ka bërë me dije se të arriturat e shtetit të Kosovës të prezantuara në këtë forum u vlerësuan lart, duke shtuar vëmendjen e përfaqësuesve të shteteve të pranishme për përvojën e Kosovës në rrugëtimin e saj në këto procese. "Në përfundim të këtij forumi të Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore theksova se

agjenda e reformave në një shtet kërkon vullnet të fortë politik dhe konsultime përmbajtjesore të brendshme dhe të jashtme, me rol të veçantë të partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile duke i dhënë kuptim pozitiv përfundimtar një procesi reformues. Me moton 'në shërbim të qytetarëve' potencova se rezultatet e reformave në qeverisje rrisin jo vetëm shërbimin ndaj qytetarëve, por edhe vlerësimin dhe respektin për secilin shërbues publik", ka thënë Tahiri.

Pjesëmarrës në këtë forum ishin 41 shtete me 400 anëtarë nga sektori publik dhe privat, akademik dhe nga shoqëria civile. Në kuadër të këtij forumi u diskutuan të arriturat e reformave në qeverisje dhe hapat që duhen shtyrë në të ardhmen në këtë fushë.

Ministri Bytyqi: Së shpejti studime pa pagesë në Republikën e Çekisë

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqyri Bytyqi, ka pritur në takim drejtuesin kryesor të CERGE-EI në Pragë të Çekisë, profesorin Randall K. Filer, me të cilin ka biseduar lidhur me arsimin e lartë në Kosovë. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka bërë me dije se shumë shpejt do të

nënshkruhet një marrëveshje e cila do t'u mundësojë studentëve nga Kosova që të studiojnë në Çeki. "Qendra për kërkime ekonomike dhe pasuniversitare - Instituti i Ekonomisë, i njohur si CERGE-EI - është institucion akademik në Pragë, i specializuar vetëm për fushën e ekonomisë. Lajmi më i mirë është se shumë shpejt do të

nënshkruhet një Marrëveshje Bashkëpunimi, përmes së cilës do t'u mundësonim studentëve nga Kosova studime pa pagesë në PhD dhe me kushte të volitshme në master, në fushën e ekonomisë në Republikën e Çekisë", ka shkruar Bytyqi në llogarinë e vet në "Facebook" pas takimit me profesorin Randall K. Filer.



Zëvendësndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, është pritur në takim nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri

Nënshkruhet protokoli për marrëveshjen e ekstradimit në mes të Kosovës dhe ShBA-së

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, dhe zëvendësndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, kanë nënshkruar të enjten në Prishtinë protokollin për marrëveshjen e ekstradimit në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Me këtë rast, ministri Tahiri ka vlerësuar se nënshkrimi i këtij protokoli shënon një rast historik për marrëdhëniet dypalëshe në mes dy vendeve në fushën e bashkëpunimit juridik. Ai ka thekuar se traktati pasqyron realitetin e ri në Ballkan dhe, sipas Tahirit, kjo marrëveshje fuqizon edhe më tej sundimin e ligjit dhe subjektivitetin e Kosovës



protokoli i jep një kahe krejt të re bashkëpunimit mes dy vendeve, duke rritur bashkëpunimin në fushën e sundimit të ligjit, si dhe duke u ofruar prokurorëve dhe autoriteteve të tjera në të dyja anët e Atlantikut mjete të reja për

t'i sjellë kriminelët para drejtësisë. Në një takim paraprak me zëvendësndihmësin e sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ministri Tahiri e ka njoftuar atë për reformat e ndërmarra në sistemin e drejtësisë, përfshirë

politikat e reja penale, politikat e të drejtave pronësore si dhe masat e ndërmarra në kuadër të agjendës 'Drejtësia 2020' për përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, dhe zëvendësndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, kanë nënshkruar të enjten protokollin e instrumenteve të ratifikimit të Marrëveshjes së Ekstradimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me këtë rast, ministri Tahiri ka theksuar se ky nënshkrim shënon një rast historik për marrëdhëniet dypalëshe në

mes dy vendeve në fushën e bashkëpunimit juridik. Ai ka thënë se traktati pasqyron realitetin e ri në Ballkan dhe, sipas ministrit Tahiri, kjo marrëveshje fuqizon edhe më tej sundimin e ligjit dhe subjektivitetin e Kosovës, duke e bërë një partner të besueshëm në luftën kundër krimit transnacional. "Traktati është simbol i bashkëpunimit të shkëlqyer në mes dy vendeve dhe pasqyron parimet për luftimin efikas të krimeve që janë karakteristike për shekullin 21", është shprehur ministri Tahiri. Ai ka vlerësuar se nënshkrimi i këtij

Kurti prezanton pesë pika për shkollimin dhe punësimin e të rinjve

PRISHTINË, 13 QERSHOR - (ER) Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, të enjten ka folur për universitetin, ekonominë dhe sfidat drejt një shoqërie që prodhon dije dhe punësim për të rinjtë. Në një bashkëbisedim me studentët e Universitetit të Prishtinës ai e ka akuzuar pushtetin për vjedhje të parasë publike. Me këtë rast, Kurti ka prezantuar pesë pika të Lëvizjes Vetëvendosje për shkollimin dhe punësimin e të rinjve. "Së pari, Lëvizja propozon një sistem të integruar dhe organik midis ekonomisë dhe arsimit, midis edukimit dhe arsimit. Këto duhet të shkojnë dora-dorës dhe jo njëra pas tjetrës. Nuk mund të mendosh për shkollimin pa e menduar punësimin dhe nuk mund të mendosh për punësimin pa e menduar çfarë shkollimi ka ai që do të punësohet. Ky është ndryshimi kryesor që Lëvizja e ka në Alternativën e saj qeverisëse karshi qeverive të mbrapshta të pasluftës", ka deklaruar Kurti. Kurse si pikë e dytë ai ka thënë se



universiteti duhet të jetë jo vetëm vend për konsumimin e dijës, por edhe për prodhimin e saj. Kurti ka theksuar se këtë e mundësojnë institucionet, një buxhet që të ne është inekzistent për kërkime shkencore. Sipas Kurtit, pa kërkime shkencore

universiteti do të fillojë t'i ngajë shkollës së mesme, e kur kjo të ndodhë atëherë do të duhet edhe një fakultet tjetër më pas. "Së treti, në Kosovë ka keqinvestime dhe paratë dërgohen në shtigje të gabuara. Ta zëmë, dhjetë fish më shumë shteti i

Kosovës jep për asfalt sesa për universitet. Këto keqinvestime për nga karakteri kanë dy elemente motivuese: elementi i parë ka investime aty ku mund të vidhet më shumë dhe elementi i dytë investimet nuk fokusohen në punësim, por në kapital.

'Bechtel'-it, diku një milion ia kemi dhënë në ditë, e diku 24 mijë ia kemi marrë si paga për punëtorët. Neve na duhen investime që sjellin punësim. Investime në ekonomi, jo në infrastrukturë të një ekonomie që nuk ekziston", ka treguar Kurti. Ndërsa si pikë e katërt ai ka thënë se studentët më të mirë të nivelit master duhet të inkurajohen për të qëndruar brenda sistemit edukativ të nivelit të mesëm. "Kemi nevojë për një freski në shkollat e mesme. Kjo do të bëhej kur studentët më të mirë të masterit nuk i lëmë të ikin, por i mbajmë përbrenda sistemit arsimor", është shprehur Kurti. Si pikë të pestë ai ka përmendur rëndësinë e urëzimit të arsimit dhe ekonomisë, të bizneseve me universitetin. Sipas Kurtit, këto janë elementet kryesore që i parashohim se si të dalim nga kriza aktuale dhe të ecim përpara. "Vullnetin e kemi, përvojat e të tjerëve janë, duhet vetëm një qeveri tjetër e cila do t'i zbatojë ato", ka deklaruar Kurti.

OAK-u dhe delegacioni nga Kongo diskutojnë për mundësitë e eksportit të produkteve të Kosovës

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Udhëheqësit e Odës së Afarizmit të Kosovës pritën në një takim njoftues delegacionin e bizneseve nga Kongo, me të cilin u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit të bizneseve të të dyja vendeve dhe potencialet e eksportit të produkteve tona në shtetin e Kongos.

Anëtarët e Bordit të OAK-së, Diamant Elshani dhe Hamdi Malushaj, shpalosën para delegacionit potencialet e bizneseve të Kosovës dhe fushat në të cilat kanë fokus më të madh për të eksportuar, duke theksuar që bizneset në vendin tonë funksionojnë me teknologjinë më të fundit dhe kryesisht gjermane, duke prodhuar produkte shumë cilësore të cilat përbushin të gjitha kriteret sipas standardeve.

Në këtë mes OAK-u po shtyn shtetin e Kosovës që të investojë edhe më shumë në ofrimin e

standardeve për produktet që prodhohen në Kosovë, duke u krijuar kushte sa më të mira për licencim të produkteve vendore.

Delegacioni nga Kinshasa, Kongo, udhëhequr nga Larousse Kabula Mavula Kisalu, njëherësh edhe guvernator i provincës në Kongo, ka theksuar se janë shumë të interesuar që të bashkëpunojnë me bizneset e Kosovës pasi, sipas tij, kanë nevojë për shumë produkte dhe lëndë të parë të cilat i importojnë nga vendet e tjera si: India, Kina, Turqia, por që janë të interesuar për të bashkëpunuar edhe me vendet e tjera.

Gjatë këtij takimi u shkëmbyen edhe ide për bashkëpunim nga të dyja palët, duke e konsideruar si një takim shumë konstruktiv drejt zgjerimit të tregjeve për bizneset e Kosovës dhe gatishmërinë për investime të dy



anshme. Republika Demokratike e Kongos, e njohur edhe si DR

Congo apo DROC, është një vend i vendosur në Afrikën Qendrore, me kryeqytet

Kinshasa dhe një popullsi prej 81.34 milionë banorësh, që gjuhë zyrtare kanë frëngjishten.

240 nxënës të Shkollës Fillore 'Hasan Prishtina' vizituan fabrikën e ujit në Shkabaj

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Rreth 240 nxënës të klasave të pesta të Shkollës Fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë, të shoqëruar edhe nga mësimitshënësët e tyre, kanë vizituar të enjten fabrikën e trajtimit të ujit në Shkabaj. Ata u njoftuan nga afër me procesin e trajtimit të ujit të pijshëm, cilësinë e ujit, rëndësinë dhe vlerat e tjera të ujit. "Nxënësit e kësaj shkolle ishin mjaftuëshëm të vetëdijësuar për përdorimin e drejtë të ujit të pijshëm, shpenzimin racional dhe kursimin e tij shkajshmërisht, gjithnjë duke poten-

cuar rezervat e burimeve ujore që ka Republika e Kosovës", është thënë në njoftimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh.a. Në kuadër të kësaj vizite është mbajtur edhe një ligjëratë nga stafi i KRU "Prishtina" sh.a., me ç'rast vizitoi aeratorin dhe dhomën operuese të procesit të trajtimit. Disa prej nxënësve mbanin në duar punime që i kishin bërë enkas për t'ia dhuruar stafit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh.a. dedikuar kursimit të ujit të pijshëm.



KEDS-i ndërton dy linja të reja për furnizim të energjisë në Mitrovicë



MITROVICË, 13 QERSHOR (ER) - KEDS-i ka përgatitur dy linja të reja që do të lëshohen në punë

deri në fund të javës për furnizim me energji elektrike të Mitrovicës. Këto linja do të

lidhen në nënstationin e ri të KOSTT-it Ilirida dhe do ta bëjnë shpërndarjen e energjisë

elektrike për Mitrovicën dhe fshatrat përreth. Këtu përfshihet qendra e qytetit me fshatra dhe shumë lokalitete të tjera. "Me lëshimin në punë të këtyre linjave parashihet që furnizimi me energji elektrike i këtij qyteti të jetë shumë më stabil. Kjo pjesë e Mitrovicës deri tash është furnizuar nga linja 35 kV që vinin nga Vushtrria përmes Skenderajt e deri në Mitrovicë, ndërsa linja e dytë është për nënstationin Shupkvc i cili tani është duke u furnizuar nga nënstationi Trepça përmes linjave 35 kV. Por, tashmë linjat 35 kV do të eliminohen komplet, duke bërë që furnizimi të jetë shumë më efikas dhe më ekspeditiv",

është thënë në komunikatën e KEDS-it.

Këto dy linja do ta bëjnë ndër-lidhjen nga nënstationi Ilirida me ata të KEDS-it- Mitrovica dhe Shupkvc i. "Ky hap do ta zgjidhë përfundimisht furnizimin me energji elektrike të një pjesë të konsiderueshme të qytetit, pasi qendra, lagjet e afërta dhe disa fshatra dekada me radhë janë furnizuar nga asetet e Trepçës, shumë të vjetruara. Tash KOSTT ka ndërtuar asetet e veta, KEDS ka ndërtuar menjëherë linjat e reja për ta bërë ndër-lidhjen e tyre me rrjetin distributiv dhe përfitues janë mijëra konsumatorë", është theksuar më tutje në këtë komunikatë.

Kontrollohen 272 hotele, mbyllen 29 prej tyre

Policia e Kosovës ka realizuar një operacion policor në 272 lokale hoteliere në nivel vendi duke mbyllur 29 prej tyre për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, para dy ditësh ka lëshuar një urdhëresë që obligon inspektoratin e ministrisë dhe inspektoratet komunale të bëjnë inspektime nëpër motele duke kontrolluar për mundësinë e mashtrimit të konsumatorit



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Policia e Kosovës gjatë një operacioni policor të realizuar në 272 lokale hoteliere në nivel vendi ka mbyllur 29 prej tyre për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore.

Policia përmes një njoftimi për media të enjten ka treguar arsyet e mbylljes së këtyre 29 moteleve. "Lidhur me operacionin policor të filluar më 11 qershor 2019, ku në fokus ishin veprimtaritë e kundërligjshme në objekte hoteliere, ju njoftojmë se deri tani operacioni është realizuar sipas planifikimeve të parapara. Operacioni policor është realizuar në bashkëpunim me autoritetet e tjera me ç'rast janë kontrolluar 272 lokale (motele/bujtina) dhe ka rezultuar me mbylljen e 29 lokaleve të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara sipas procedurave

dhe ligjeve në fuqi. Ashtu siç është bërë me dije më 11.06.2019, një rast është adresuar sipas kompetencës lëndore të njëjti rajonal në Prishtinë për posedim ilegal të narkotikëve dhe disa raste të tjera si në vijim: një rast është adresuar të njëjtit kompetent në Prizren, me dyshimin për veprën penale 'marrëdhënie seksuale me personin nën moshën 16-vjeçare', ku janë konfiskuar dy dokumente (të dy shtetaseve të Shqipërisë) që janë hasur në Pejë, pa leje qëndrimi, për procedura të mëtejme", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës. Policia ka shtuar se në përpjekje për parandalimin dhe luftimin e veprimtarive të kundërligjshme, ka zhvilluar planin operacional në drejtim të identifikimit të të gjitha objekteve hoteliere, moteleve (bujtinave) në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ku të targetuara kanë qenë mbi 100

objekte. "Ky aktivitet është zhvilluar duke përdorur edhe resurset e tjera institucionale në bashkëpunim me institucionet përkatëse që kanë për domen këtë fushë të veprimtarisë ekonomike. Për bashkërendim të procedurave ligjore janë kontaktuar të gjitha prokuroritë kompetente në të gjitha regjionet respektive të Republikës së Kosovës", ka njoftuar policia.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, para dy ditësh ka lëshuar një urdhëresë që obligon inspektoratin e ministrisë dhe inspek-

toratet komunale të bëjnë inspektime nëpër motele duke kontrolluar për mundësinë e mashtrimit të konsumatorit. Shala ka thënë se kjo është duke u bërë në vazhden e mbrojtjes së konsumatorit. "Kam urdhëruar inspektoratin e Ministrisë së Tregtisë që në koordinim të ngushtë me inspektoratet komunale të marrin një aksion për inspektimin dhe verifikimin e të gjitha dokumenteve si dhe higjienës të secilit motel në Republikën e Kosovës. Këtë aksion është duke e mbështetur edhe Policia e Kosovës. Ne

jemi të përkushtuar që të gjitha shërbimet që ofrohen në Kosovë të kenë cilësi në mënyrë që të mbrohet konsumatori dhe të eliminohet mundësia për mashtrim. Kjo urdhëresë është në vazhden e punës që jemi duke e bërë në mbrojtje të konsumatorit dhe për të vendosur rend dhe rregull", ka thënë ministri Shala. Në këtë aksion është duke asistuar edhe Policia e Kosovës dhe organet e tjera shtetërore. Në urdhëresë obligohen të gjitha inspektoratet që të ndërmarin veprime kontrolli për të gjitha motelet.

Reçica në Luksemburg prezanton reformat e ndërmarrja nga MPMS-ja

**EPOKA
ERE** A. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, me ftesë të Presidencës së BE-së dhe Komisionit Evropian, po merr pjesë në EU-konferencën ministrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Luksemburg, e cila po organizohet nga treshja e Presidencës së BE-së, ajo aktuale rumune, e Finlandës dhe e Kroacisë, së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian për Punësim dhe Çështje Sociale.

Ministri Reçica në këtë konferencë paraqiti sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova, si papunësia e lartë, mospërpudhja e aftësive profesionale të fuqisë punëtore me nevojat e tregut të punës, zhvillimi i ulët ekonomik, si dhe investimet e huaja të pakta. "Qeveria e Kosovës është

e përkushtuar që t'i avancojë reformat e nevojshme, me qëllim të krijimit të më shumë vendeve të punës, t'i nxisë investimet e huaja, të ketë koordinim më të mirë në mes të institucioneve të vendit për edukim dhe aftësim profesional, për krijimin e kadrove profesionale me aftësitë dhe shkathtësitë e kërkuara", ka thënë Reçica.

Ai ka shtuar se plani i punësimit të rinjve dhe strategjia sektoriale e MPMS-së janë dy dokumente strategjike të Qeverisë së Kosovës të cilat adresojnë qartë këto sfida, si rritja e punësueshmërisë, ulja e inaktivitetit, arsimi dhe aftësimi profesional, janë objektiva dhe prioritetet të cilat janë vendosur të arrihen me këto dokumente.

Nga Presidenca kjo konferencë u konsiderua historike sepse për herë të parë organizohet një konferencë e tillë në nivel më të lartë politik, në atë ministror



dhe pikërisht kjo i jep rëndësi konferencës, sepse punësimi dhe çështjet sociale kërkojnë vendimmarrje dhe përkushtim nga aktorët më të lartë qeveri-

tarë. Vendet e Ballkanit Perëndimor aspirojnë për t'u integruar në Bashkimin Evropian, andaj duhen bërë reforma të nevo-

jshme dhe përpjekje që ta arrijnë këtë qëllim, të krijojnë kushte punësimi për vendin, njëkohësisht të anëtarësohen në BE.

2 193 nxënës të Ferizajt i nënshtrohen testit të maturës

FERIZAJ, 13 QERSHOR (ER) - Në bazë të përzgjedhjes me short nga Ministria e Arsimit, Ferizajt i është caktuar dita e enjte për ta mbajtur Testin e Maturës, të cilit i janë nënshtuar 2 193 nxënës ferizajas. Për t'i parë nga afër përgatitjet dhe ndjekur ecurinë e këtij testimi, ka dalë edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Llabjani. Ata kanë vizituar Shkollën e Mesme të Lartë Teknike "Pjetër Bogdani", ku

janë pritur nga udhëheqja e kësaj shkolle dhe monitoruesit e Komisionit Shtetëror të Maturës. Në vizitën në disa nga dhomat e testimit në këtë shkollë, Aliu u ka uruar suksese të gjithë nxënësve ferizajas. Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Llabjani, ka theksuar se institucioni që drejton ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura dhe me kohë për mbajtjen e këtij testi. "Nga informatat që kam marrë nga terreni dhe nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, gjithçka

është duke shkuar në rregull, testet kanë ardhur me kohë, nxënësit kanë qenë me kohë të paraqitur në qendra të testimit dhe si rezultat i kësaj ne kemi 2 193 nxënës të cilët i janë nënshtuar testit ditën e sotme në gjithsej 17 qendra të testimit, janë këto qendra që janë përcaktuar nga Ministria e Arsimit në mënyrë që të ketë sa më pak nxënës nëpër paralele, që mbikëqyrja dhe kontrolli të jetë sa më i mirë dhe sa më i suksesshëm", ka thënë Llabjani.



Sot mbahet debati i deputetëve me qytetarë të Prishtinës

Prishtinë, 13 qershor (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës, me iniciativën e Forumit për Transparencë Parlamentare, vazhdon aktivitetin Ditët e Kuvendit 2019, duke ua dhënë mundësinë qytetarëve të komunave të ndryshme që nëpërmjet takimeve publike me deputetë, t'i adresojnë shqetësimet dhe kërkesat e tyre. "Takimi i radhës do të

mbahet në Prishtinë, të premten, më 14 qershor 2019, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë, në orën 14:00", është bërë me dije në njoftimin e Kuvendit të Kosovës. Deputetët Blerta Deliu-Kodra (PDK), Fitore Pacolli (LV), Teuta Haxhiu (AAK), Dardan Sejdiu (PSD) dhe Haxhi Shala (Nisma) do të përgjigjen në pyetjet e qytetarëve.

Tri fshatra të Malishevës bëhen me kryetarë dhe kryesi të re

Malishevë, 13 qershor (ER) - Në Komunën e Malishevës po vazhdon procesi i mbajtjes së zgjedhjeve në të gjitha fshatrat dhe vendbanimet. Në kuadër të këtij procesi janë mbajtur zgjedhjet në tri fshatra Turjakë, Lubizhdë dhe Marali, ku janë zgjedhur krye-

sitë dhe kryetarët e këtyre fshatrave, të cilët do të punojnë dhe do t'i përfaqësojnë fshatrat e tyre.

Në zgjedhjet e mbajtura në fshatin Turjakë kryetar është zgjedhur Haxhi Kastrati, në Lubizhdë është rizgjedhur kryetar Bajram Bytyçi dhe në

Marali kryetar është zgjedhur Hasan Vrenezi. Po ashtu, janë zgjedhur edhe kryesitë e këtyre fshatrave. Procesi i mbajtjes së zgjedhjeve do të vazhdojë deri në përfundimin e zgjedhjeve në secilin fshat dhe vendbanim të Komunës së Malishevës.

DITËT E KUVENDIT 2019

Takim me qytetarët e Prishtinës

14 qershor 2019, e Premte në ora 14:00 në sallën e Kuqe - Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve



Blerta Deliu-Kodra



Fitore Pacolli-Dalipi



Teuta Haxhiu



Dardan Sejdiu



Haxhi Shala

Ky takim organizohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me Iniciativën e Forumit për Transparencë Parlamentare

'MobileZone' ofron bursë për një student nga Drenasi

DRENAS, 13 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me pronarin e kompanisë "MobileZone", Abdullah Zenelin, për të ndihmuar një student të kësaj komune me bursë për vitin akademik të studimeve 2018-2019.

Kryetari Lladrovci ka falënderuar Abdullah Zenelin për këtë ndihmë që ka ofruar për t'i përkrahur studentët e Komunës së Drenasit dhe ka vlerësuar se përmes kësaj ndihme do të lehtësohet sadopak barra familjare për studentët.

Kompania "MobileZone", me pronarë Abdullah Zeneli, do të ndajë bursën për studentin nga lista pritëse e përfituesve sipas konkursit të shpallur më 5 tetor 2018. Nga lista pritëse e përfituesve të bursave kanë mbetur edhe 13 studentë pa marrë bursën, ndërsa së shpejti do të njoftohen studentët përfitues për përkrahjen nga donatorët e tjerë. Komuna e Drenasit nga buxheti ka ndarë 140 bursa për studentët e nivelit bachelor dhe 20 për nivelin master, ndërsa pjesa tjetër përmes donatorëve. Gjithsej përfitues të bursave janë 227 studentë.



Në burgun e Nishit dëgjuam në lajme se lufta në Kosovë ka mbaruar



SADIK ZEQRIRI

Atë ditë ishte 9 qershori i vitit 1999. Në burgun e Lipjanit ishim shumë të burgosur shqiptarë. Na kishin transferuar aty policia dhe ushtria serbe nga burgu i Dubravës nga 24 maji deri më 10 qershor. Aty gardianët dhe të burgosurit, të cilët kishin mundësi të lëviznin ose duke sjellë bukë ose duke punuar në oborrin e këtij burgu, na njoftuan se pritej të nënshkruhej një marrëveshje në mes të NATO-s dhe ushtrisë së Serbisë në Kumanovë të Maqedonisë. Ne ishim në dhomën numër një të katit të parë, në njërin prej pavijoneve të atij burgu. Dritaret tona ishin të kthyera kah objektet e tjera të burgut. Nganjëherë me zë të çirret kishim mundësi të komunikim edhe me të burgosurit që gjendeshin në dhomat e tjera pa rënë në vesh dhe sy të gardianëve. Jashtë objektit dëgjoheshin gjuajtje me armë, bombardime të NATO-s, të cilat cak e kishin majën e Goleshit. Më në fund, erdhi lajmi i gëzuar dhe i shumëpritur. Na u tha që sot është dita e fundit, se ose do ta nënshkruajnë marrëveshjen me Serbinë për largimin e policisë dhe ushtrisë nga Kosova, ose NATO-ja do të futej me

këmbësori në Kosovë për t'i nxjerrë jashtë. Këtë informatë na dha një i burgosur i nacionalitetit joshqiptar. Atë e kishte bërë shok dhoma jonë. Prej tij një pako cigare e blinim deri në 1 000 marka gjermane. Sigurisht dëshironi të pyesni ku i morëm të gjitha ato para në burg? Ja po ju tregoj. Një grup të madh të Gjakovës policia dhe ushtria serbe e kishte arrestuar dhe e kishte sjellë në burgun e Dubravës, kurse më 24 maj të gjithë ata të burgosur i sollë në Lipjan. Ata me vete kishin pasur mjaft para. Ishin nisur për të shkuar në Shqipëri, por ishin zënë dhe arrestuar e ballafaquar me tortura, vrasje dhe burgim. Në dhomën tonë kemi qenë mbi 50 të burgosur. 45 prej tyre kanë qenë nga grupi i Gjakovës, kurse pesë veta kemi qenë të burgosur më të vjetër, ndër ta edhe unë. Meqë grupi i Gjakovës kishte shumë para me vete, me to blinim cigare me çmim shumë të lartë. Për

shembull, e porositim një paketë cigare "Marlboro" dhe e paguanim 100 marka por, kur ajo vinte te ne, vinte ose "Best", ose "Vek", ose "Drina", ose "Morava". "Marlboro" na erdhi vetëm kur një boks e paguam 1 000 marka. Në mëngjesin e datës 10 qershor u zgjuam nga zhurma e madhe e gardianëve të cilët i kishin ndezur të gjitha dritat e burgut. U zgjuam të shohim se çfarë po ndodh. Jashtë dëgjohej një zhurmë e madhe e mjeteve të blinduara dhe e autobusëve. Në këtë mëngjes aeroplanët e NATO-s nuk dëgjoheshin. Gardianët hynë në dhomën tonë dhe na morën nga dhoma mua dhe Agron Sylën. Kur na nxorën jashtë na i lidhën duart pas shpinës me litar. Na urdhëruan të shkojmë në pavijonin tjetër në katin e dytë. Kur shkua aty edhe të tjerëve ua kishin lidhur duart pas shpinës. Ashtu kemi qëndruar, me duar lidhur, deri në mëngjes. Pastaj na kanë futur në një autobus

mbushur përplot me njerëz. Nuk dinim a ka përfunduar lufta. Nuk dinim çfarë do të bënin me ne. Nuk dinim ku do të na dërgonin. Mendonim dhe dëshironim të na dërgonin në Shqipëri. Jashtë dyerve të burgut, deri tek autobusët, shumë ushtarë serbë të çaraveshur, me uniforma të zbërthyer, të lodhur e të rraskapitur, pritnin autobusët. Agroni, të cilin e kisha afër, më tha: "Sadik, po më duket po na dërgojnë për Shqipëri. Paska shumë autobusë". Duke ua lëshuar një vështrim disa prej autobusëve, në njërin prej tyre pashë emrin e kompanisë "Lasta". Menjëherë i thashë: "Jo Agron, do të na dërgojnë ose në Beograd, ose në Nish. Kjo kompani është e Serbisë". Ashtu dhe ndodhi. Na nisën për Nish. Gjatë rrugës mua më mundonte autobusi. Ishim ulur pothuajse në fund të autobusit. Ishim të veshur me rroba të trasha. Në 10 qershorin e 1999-s bënte nxehtë. Edhe më mundim na vinte ngaqë i kishim duart e lidhura pas shpinës. Pothuajse gjatë gjithë rrugës na kanë rrahur policët serbë. Na sillnin kokës, e ne nuk kishim mundësi ta mbrojmë kokën. Gjatë rrugës, sa herë që kishim mundësi të shikonim për dritare, i shihnim, në kolona të gjata, tanket, traktorët, kamionët e veturat, tri prej këtyre të fundit prona të shqiptarëve, të plaçkitura nga serbët, që me to udhëtonin për Serbi, mbushur me plaçka të tjera. Pas disa orësh rrugëtimi të trishtuar arritëm në Nish, pastaj në burgun e Nishit.

Aty u ndalën të gjithë autobusët, nisi zbarkimi i të burgosurve dhe burgimi i tyre. Vend në burgun e Nishit pati për 600 të burgosur, të tjerët, rreth 400, i dërguan për burgjet e tjera që gjendeshin në qytetet e Serbisë. Edhe mua më burgosën aty. Na vendosën nga 50 të burgosur në dhoma. Na dhanë nga një sfungjer për t'u shtrirë dhe fjetur. Etja na kishte marrë edhe më shumë sesa uria edhe pse e ndienim edhe nevojën e saj shumë sepse, për rreth dy muaj, nuk e di që kemi ngrënë 30 kilogramë ushqim. Na dërguan për të pirë ujë në fillim të korridorit, në banja. Por, sapo na lëshonin ujin, na ndërprisnin menjëherë, pastaj nga dhoma nxirrnin pesëdhjetë veta të tjerë dhe, sapo i dërgonin në banja për të pirë ujë dhe sapo ua lëshonin ujin, ua ndalnin menjëherë. Kështu ndodhi atë ditë me 600 të burgosur, të cilët i çonin për të pirë ujë, por i linin pa pirë.

Në orën 15:00, në mikrofonat që gjendeshin në dhomat e të burgosurve, u dhanë lajmet në gjuhën serbe. U dha lajmi i mirëpritur për ne shqiptarët e burgosur. Në lajme ish-presidenti i Serbisë, Slobodan Millosheviq, iu drejtua kombit serb me deklaratën për përfundimin e luftës në Kosovë dhe e njoftoi popullin serb për "fitoren" e tyre të madhe, sipas tij, ndaj NATO-s në Kosovë. "Ratje Zavershen", tha ai, kurse ne shpërthyem në lot gëzimi dhe urimi.

(Autori ka qenë i burgosur në burgun e Dubravës, të Lipjanit dhe të Nishit)



Gjermania arreston një shtetas të Kosovës, i akuzuar për mbështetjen e IS-it

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Autoritetet gjermane arrestuan një shtetas të Kosovës, i cili akuzohet se ka mbështetur grupin militant Shteti Islamik (IS), duke transferuar mijëra euro për një luftëtar dhe një rekrut të mundshëm. Zyra e Prokurorit Federal tha se 31-vjeçari, i identifikuar vetëm si Hasan Rejan B, u arrestua të mërkurën në zonën e Pinebergut, pranë Hamburgut, raporton AP. Ai dyshohet për 15 akuzat për mbështetjen e grupit militant Shteti Islamik dhe 11 akuzat për shkeljen e ligjeve gjermane të eksportit. Prokurorët thanë se i dyshuari ka bërë 11 transferime në vitet 2016 dhe 2017

për një luftëtar të IS-it në Siri. Po sipas Prokurorisë, në vitin 2015 ai i ka transferuar para një personi nga Maqedonia e Veriut, i cili dëshironte të bashkohej me luftëtarët e IS-it në Siri. Në total, ai ka transferuar rreth 15 000 euro. Sipas të dhënave zyrtare në Kosovë, nga viti 2012 deri në vitin 2016, mbi 400 qytetarë të Kosovës kanë shkuar në zonat e luftës në Siri dhe Irak. Më shumë se 130 persona janë dënuar në Kosovë për pjesëmarrje në luftërat në Siri dhe Irak. Kosova ka hartuar një ligj në vitin 2015, me të cilin çdo person që merr pjesë në luftëra të huaja mund të dënohet deri në 15 vjet burgim. (REL)



E rrallë

Djeg fustanin e nusërisë për ta festuar divorcin

Një grua i ka vënë flakën fustanit të martesës për ta festuar divorcin me bashkëshortin. Pas një martese tetëvjeçare dhe një divorci të zgjatur, Alexandria Taschwer shprehet se më në fund ndihet e lirë. 27-vjeçarja dëshironte të tregonte se përfundimi i martesës nuk nënkuptonte fundin e saj. Ndaj Alexandria festoi lirinë në mënyrën më të mirë që dinte, duke djegur fustanin.



BARSOLETA E DITËS



Në plazh fjalosen burri dhe gruaja. Në një moment burri thotë: Falënderoju fatit që këtu është pllaka në të cilën shkruan: "E ndaluar është që të hedhen mbeturinat në det", përndryshe të kisha hedhur kaheër.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00


"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



FOTO E DITES



Një fermer në Kinë shihet me një traktor gjatë sezonit të korrjes së grurit. Fotografia është publikuar te "Zëri i Amerikës".

Ne ora 16:00 dhe 19:00 "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



E jashtëzakonshme

Zbulim arkeologjik, kanabisi u tymos në Kinë 2.500 vjet më parë

Arkeologët që punojnë në një faqe kineze kanë zbuluar se kanabisi është tymosur 2.500 vjet më parë. Kjo është vërtetuar nga gjurmët e para të këtij lloji, të gjetura në qeramikën e gjetur në tetë varre në varrezën e Jirzankalit, në zonën lindore të Kinës. Rasti u shpjegua në revistën "Science



Advances" nga një grup studiuesish gjermanë dhe kinezë.



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Fillimi i kësaj dite është i dedikuar i gjithi punës. Jeni shumë të zënë me projekte që duhet t'i realizoni sa më shpejt.



DEMI

Kujdes me emocionet sot. Shumë herë shkoni në drejtim të gabuar vetëm sepse ndikoheni nga emocionet e çastit.



BINJAKËT

Familja juaj nuk është se e pranon shumë lidhjen e re sentimentale që sapo keni nisur. Një debat i papritur dhe midis partnerit dhe njerëzve të afërt.



GAFORRJA

Për me të vegjlit e shenjës shkolla apo kopshti do të sjellë angazhime të reja. Të gjithë do të jenë të shqetësuar me këtë ngjarje sot.



LUANI

Nëse keni planifikuar një udhëtim pune, mund të jini të qetë. Gjithçka do të shkojë mjaft mirë dhe ju do të ktheheni me lajme pozitive.



VIRGJËRËSHA

Gjërat në përgjithësi janë në harmoni të plotë sot për ju, përveç ndonjë problemi të vogël në çift që do të zgjidhet shpejt.



PESHORJA

Do të shuani çdo mosmarrëveshje sot si në punë edhe në familje. Në fund të ditës do të kuptoni që keni vepruar drejt.



AKREPI

Sot do të keni disa probleme sa i përket financave. Do të dalin shpenzime të pallogaritura më parë që do t'ju prishin disi rendin e ditës.



SHIGJETARI

Do t'ju përfshijnë në projekte që nuk janë ide e juaja në punë. Kjo gjë nuk është se ju pëlqen, megjithatë, do ta jepni më të mirën.



BRICJAPI

Këtë periudhë keni pasur probleme me gjumin. Bëni mirë të kujdeseni më shumë për veten dhe ta anashkaloni pjesën tjetër të ngarkesës.



UJORI

Sot ndiheni shumë nostalgjike mbase nga koha sepse kujtimet nuk ju lënë të qetë. Ka gjëra që është mirë të mos i rikujtoni shpesh.



PESHQIT

Besimi i madh që keni te miqtë tuaj vjen si pasojë e sigurisë që ju kanë dhënë në çaste të vështira. Pa ta ndiheni i humbur.

Jennifer Lawrence dhe i fejuari i saj duan të kenë fëmijë së shpejti



Jennifer Lawrence dhe i fejuari i saj Cooke Maroney kanë nisur planifikimet për dasmën e tyre, ndonëse ende dihen shumë pak detaje. Sipas një burimi të afërt me

çiftin që ka folur për "ET", aktorja dhe i fejuari i saj shpresojnë që dasmën ta bëjnë në Nju Jork, ndonëse duket se vendi nuk është vendosur ende.


Rihanna shkëlqen në të zeza



© T.Jackson / BACKGRID

Rihanna u shfaq e gjitha në një kostum të zi të mërkurën derisa po fluturonte për në Nju Jork City. Superstari 31-vjeçar

kishte veshur një bluz të zezë të thjeshtë me pantallona të gjera, ndërkohë që bënte rrugën e saj përmes Aeroportit JFK.



Bebe Rexha urren fotografiminë që i bënë paparacët

Këngëtarja e njohur me prejardhje shqiptare, Bebe Rexha, ka publikuar një fotografi në rrjetin social "Instagram". Rexha ka thënë se e urren këtë fotografi që ia kanë bërë paparacët. "E urrej

këtë fotografi të paparacëve, por ju e dini pse e postoj, sepse është e vërtetë. Isha duke blerë ca ushqime djegëse dhe një tiketë llogarie. I fitova mandej 25 dollarë", ka shkruar ajo.

Gigi dhe Bella shijojnë verë të kuqe gjatë darkës së pushimeve në Itali



Gigi dhe Bella Hadidi kanë nisur pushimet në Itali, por ato nuk mund dot të rezistojnë për ta fshehur se sa shumë po argëtoheshin derisa u panë të pinin dhe nga një gotë verë në një darkë në Florencë të

Italisë. Dy motrat supermodeluese, të moshës 24 dhe 22-veçare, u shfaqën në humor të mirë dhe këtë e dëshmojnë imazhet ku të dyja shihen të buzëqeshura derisa po shkrepin selfie rasti gjatë një darke.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045 82 82 82

Të shtunën në stadiumin 'Fadil Vokrri' ndeshja e yjeve Granit Xhaka dhe Milot Rashica

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Mbrëmja e së shtunës iu takon yjeve të futbollit shqiptar të cilët do të luajnë mes vete në një ndeshje revyale me karakter zbavitës dhe bamirës njëkohsisht. Më datën 15 qershor (e shtunë), në orën 20:00, yjet e njohur shqiptarë zbresin në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet.

Ekipi i krijuar nga mesfushori i Arsenalit, Xhaka me shokë dhe ekipi i krijuar nga sulmuesi i Werderit, Rashica me shokë, do të përballen me njëri-tjetrin, për të dhuruar spektakël për të gjithë dashamirët e futbollit në Kosovë e më gjerë.

Në njëzetvjetorin e lindjes së një jete të re, stadiumi "Fadil Vokrri" do të jetë më i ndriçuar se kurrë nga yjet e futbollit që përditë i bëjnë dritë emrit të vendit tonë nëpër botë. Kjo ndeshje organizohet dhe mbështetet nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës.

Biletat për tribunat jug dhe veri do të jenë falas, biletat për tribunën lindore kushtojnë 2 euro, kurse ato për tribunën perëndimore 3 euro. Biletat mund të blihen në kioskën e qytetit të Prishtinës si dhe në "Rave Travel". Të gjitha të hyrat nga shitja e biletave do t'u ndahen 10 familjeve në nevojë.



Dasma e Sergio Ramosit, e mbushur me yje, por Ronaldo nuk u ftua

MADRID, 13 QERSHOR - Lista e të ftuarve për dasmën e Sergio Ramosit do të jetë e mbushur me yje më 15 qershor. Por ajo që vihet re është se kapiteni i Real Madridit nuk e ka ftuar ish-shokun e ekipit, Cristiano Ronaldo.

Ramos po martohet me prezantuesen e televizionit, Pilar Rubio në katedralen e famshme të Sevilyes këtë fundjavë.

David Beckham dhe gruaja Viktoria do të jenë të pranishëm në këtë dasmë, ashtu siç është edhe rivali i tij i Barcelonës, Gerard Pique, me partneren e tij afatgjatë Shakira. Sipas "Marca"-s, Ramosi dhe Rubio kanë ftuar 500 mysafirë, në atë që po shihet si një konkurrenca për të qenë "dasma e vitit" në Spanjë. Mungesa e Ronaldos raportohet të



rrjedhë nga një hatërmetje mes dy lojtarëve, pasi ky i fundit u largua nga klubi verën e kaluar për t'u bashkuar me Juventusin.

Dasma do të jetë e mbushur me një mori fytyrash të njohura, duke përfshirë menaxherin e Real Madridit,

Zinedine Zidanen dhe presidentin e klubit, Florentino Perezin. Shpresohet se ish-portieri i Real Madridit, Iker Casillas, është në listën e të ftuarve, por pjesëmarrja e tij nuk është konfirmuar pas sulmit në zemër që pësoi së fundmi.

SHKURT

E goditi me këmbë fanellën e Kombëtares, Ylber Ramadani kërkon falje

TIRANË, 13 QERSHOR -

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë ka sqaruar situatën e cila ka hapur polemika mes tifozëve. Ylber Ramadani realizoi një gol të bukur në minutat e fundit të takimit ndaj Moldavisë të cilin Shqipëria e fitoi 2-0. Gjatë festës së golit ai nuk kontrolloi emocionet duke hequr fillimisht fanellën e më pas edhe e goditi atë me këmbë. Ky gjest i Ramadani është përfolur shumë në mesin e tifozëve, të cilët e kanë kritikuar lojtarin. Por ai ka zgjedhur rrjetin social "Instagram" për ta sqaruar këtë situatë, njëherësh u ka kërkuar ndjesë të gjithë atyre që janë ndjerë të ofenduar.



Ekipi i rikthyer në Premierë Ligë kërkon Riberyn

LONDËR, 13 QERSHOR -

Veterani francez mund të luajë në Premierë Ligë që nga sezoni tjetër. Franck Ribery është larguar nga Bayern Munihi pas 12 vjetëve të kaluar me gjigantin gjerman, ku ka fituar të gjithë trofetë e mundshëm. Tani si lojtar i lirë 36-vjeçari ka shumë oferta, por ende nuk ka zgjedhur se ku do ta vazhdojë karrierën. Mediat në Angli raportojnë që ekipi i sapokthyer në Premierë Ligë, Sheffield United, i ka bërë një ofertë Riberys. Ish-reprezentuesi i Francës ka ofertat edhe nga Australia dhe Katari dhe është duke i shqyrtuar të gjitha para se të vendosë se ku do të luajë në të ardhmen.



U raportua se do të pensionohet, Casillas mohon gjithçka

MADRID, 13 QERSHOR -

Portieri spanjoll ende nuk ka marrë një vendim për të ardhmen e tij. Iker Casillas ka reaguar menjëherë pas raportimeve të mediave portugeze se ai do të pensionohet nga futbollit. 38-vjeçari që luan me Porton me datën 1 maj kishte pësuar një sulm në zemër dhe është ende duke kryer disa kontrole, para se të merret vendimi nga mjekët nëse guxon të kthehet sërish apo do t'i duhet të pensionohet. Ai përmes "Twitter"-it ka lënë të hapur mundësinë që të kthehet përsëri në fushën e gjelbër. "I njëjti shkrim sikurse ai i një muaji më parë. Vendimi do të merret vetëm pasi t'i kryej kontrollet", ka shkruar Casillas.



Ekipi i xhudos vazhdon përgatitjet në Poreç të Kroacisë

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Ekipi i seniorëve, juniorëve dhe kadetëve, pas përgatitjeve në Koln (femrat) dhe në Berlin (meshkujt), këtë javë po vazhdojnë përgatitjet

në Poreç të Kroacisë, ku po mbahet Festivali i Xhudos për herën e gjashtë me radhë. Seniorët e kanë përgatitjen finale para Lojërave Olimpikë Evropiane, juniorët për

Kupat Evropiane të radhës, kurse kadetët për Festivalin Olimpik Evropian për të rinj. Atje po mbahen edhe stërvitje për grupmoshat e reja, seminar me

xhudistët me nevoja të veçanta si dhe seminar lidhur me administrimin dhe organizimin, siç janë projektet e edukimit, mediave dhe anti-dopingut.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO
ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTIA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në Rekomandimin e Këshillit Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës, së datës 11.06.2019, me Nr. të Protokollit 2312/2019, dhe Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit, në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, njofton për anulimin e konkursit (rekrutim i brendshëm) të shpallur, me datë 27.05.2019, me Nr. të Referencës 25/2019, për pozitën Drejtor i Muzeut Kombëtar të Kosovës, për shkak të mospërbushjes së kriterit të kandidatëve aplikues, me më së paku 3(tre) kandidat, të cilët iplotësojnë kriteret, për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për këtë pozitë.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, na osnovu Preporuke Upravnog Saveta Nacionalnog Muzeja Kosova, datuma 11.06.2019, sa Br. Protokola 2312/2019, i Pravilnika o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, obaveštava anuliranje konkursa (interna regrutacija) objavljenog 27.05.2019, sa Referentnim Br.25/2019, za poziciju Direktora Nacionalnog Muzeja Kosova, zbog neispunjavanja kriterijuma od strane kandidata koji su aplicirali, sa najmanje 3 (tri) kandidata koji ispunjavaju kriterijume, za sprovođenje postupka regrutacije za ovu poziciju.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Krushë e Vogël"**

Komuna: **Krushë e Vogël**

Data: **14.06.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/086-G/1.2	Blerja e mjeteve didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: **Shfmu "Krushë e Vogël" Krushë e Vogël, Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- **Mjete didaktike për Matematikë**
- **Mjete didaktike për Biologji**
- **Mjete didaktike për Fizikë**
- **Mjete didaktike për Gjeografi**
- **Mjete didaktike për Arte**
- **Mjete didaktike për Ed. Fizike**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: **Shfmu "Krushë e Vogël" Krushë e Vogël, Prizren**, më së largu deri më **21.06.2019**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret.

Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Shpresa Shehu**

Telefoni: **044/126 622, 044/215 907**

E-maili: **shehushpresa@live.com**

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **ShFMU "Nefit Jusufi"**

Komuna: **Prizren**

Data: **14.06.2019**

Emri i kontratës: **Pasurimi i mediatekës shkollore**

Numri i kontratës: **ESIP/C1.3/088 - ESIP/SDG/088-G/1.1**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollën **SHFMU "Nefit Jusufi"** në Skorobisht, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i mallrave të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- **Pasurimi i mediatekës shkollore me: 1 laptop, 1 projektor, 1 TV aparat, 1 printer dhe 4 tastatura me maus**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën **SHFMU "Nefit Jusufi"**, Skorobisht, Prizren më së largu deri më **21.06.2019**.

4. Termat e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ua dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Ramit Jusufi**

Nr. i telefonit: **044 621 341**

E-mail: **shfmunefitjusufi@gmail.com**

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Xhevë Lladrovci"**

Komuna: **Drenas**

Data: **14.06.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/143-CS/1.4	Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkolla

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Xhevë Lladrovci" Drenas**. Objektiv i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e menaxhimit, monitorimi, cilësisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Xhevë Lladrovci" Drenas, më së largu deri më datën; 24.06.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Valdet Nika**

Telefoni: **049/978-533**

E-maili: **valdetnika@hotmail.com**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

SHPALLJA E REKRUTIMIT **Oglas za regrutiranje**

Institucioni: Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Institucija: Ministarstvo Infrastrukture i Transporta

Institucioni/institucija MIT/MIT **kërkon të punësojë** (titullin e pozitës) në (departamentin/drejtoratin/divizionin/njësinë)e /zeli da regrutuje (naziv posla u odjeljenju/direkciji/diviziji ili sektoru) **Divizioni për Prokurim/ Divizija za nabavku:**

Titulli i vendit të punës /Naziv radnog mesta: Zvrtar/c i/c Lartë i/c Prokurimit (2 pozita)/ Visoki službenik/ca za nabavke (2 pozicije)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës? Niveli profesional 3 grada 8 (BKK 8), Funkcionalna kategorija i stepen radnog mesta/ Nivo upravljanja 3-stepen 8 (BKK 8),

Numri i referencës së vendit të punës/Broj radnog mesta/ RN00005044

(Shënoni saktësisht por me pak fjale detyrat dhe përgjegjësitë kryesore)/(Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti):

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet
- Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim janë në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik
- Përgatit kontrata dhe siguron që metodat e prokurimit dhe teknikat janë të kuptueshme dhe zbatohen nga ana zyrtare të tjerë të prokurimit
- Përgatit forma dhe procedura standarde, varësisht nga metoda e prokurimit dhe siguron që ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimi i tyre është bërë me kohë
- Siguron mbajtjen e të dhënave detale për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikqyrsi
- Izrađuje planove rada u saglasnosti sa nadzornikom za sprovođenje postavljenih zadataka na osnovu objektivna jedinice i daje preporuke u vezi realizovanja objektivna jedinice
- Rukovodi radnim grupama na specifičnoj profesionalnoj oblasti i vrši specijalizovane zadatke iz specifične oblasti, kao i pomaže drugom osoblju institucije na realizovanju njihovih zadataka i odgovornosti
- U saradnji sa nadzornikom analizira realizovanje objektivna i plana rada jedinici, izrađuje izveštaje o postignutom napredku i preporučuje pospoljšanja ako se to zahteva
- Vodi računa da svi zahtevi za nabavku budu u skladu sa zakonodavstvom i pravilima javne nabavke
- Priprema ugovore i vodi računa da metode i tehnike nabavke budu razumljive i da se sprovede od strane sotalih službenika nabavke
- Priprema obrazce i standardne procedure, u zavisnosti od metode nabavke i vodi računa da pozivi za podnošenje ponuda za tender i njihovo slanje budu izvršeni na vreme
- Vodi računa za čuvanje detaljnih podataka učesnika na tenderu, podatke o donetim odlukama, kao i o potpisivanju komentara od svakog člana komisije
- Izvršava i ostale zadatke u skladu sa ciljem radnog mesta koje se mogu zahtevati povremeno od strane nadzornika

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim - Uslovi za učešće na regrutaciji

(Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil/Navedite uslove za učešće u procesu regrutacije po Zakonu Javne Službe/

Procedurat e konkurrimit-Procedure konkurisanja

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civilë ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civilë ekzistues - Navedite da li je procedura konkurisanja javna za spoljne kandidate, ili da li je procedura interna samo za postojeće civilne službenike

Procedura e konkurrimit është e hapur për gjithë kandidatet te jashtëm si dhe për nëpunës civil/ Procedura konkurisanja je objepljena i za javne službenike koji rade u intitucije .

Shkollimi i kërkuar/Minimum obrazovanja koje se zahteva:

(Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/(Navedite stepen obrazovanja koje se realno traži za ovo radno mesto)/

- **Diplomë Universitare: Ekonomik, Juridik, Elektro, Arkitekturë, Ndërtimtari / Univerzitetska Diploma: Ekonomski, Pravni, Elektrotehnike, Arkitekture, Gradevinarstva**

Aftësitë,përvoja dhe atributet tjera që kërkohen/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

(Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat mundin më qenë të dëshiruara. Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive./Opišite sposobnosti, iskustvo i lične osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One moraju da budu povezane sa radon i da budu objektivne.

- Diplomë Universitare: Ekonomik, Juridik, Elektro, Arkitekturë, Ndërtimtari
- Tri (3) vitë përvojë pune profesionale
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e prokurimit publik
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)
- Univerzitetska Diploma: Ekonomski, Pravni, Elektrotehnike, Arkitekture, Gradevinarstva
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva.
- Odlična znanja o specifičnoj profesionalnoj oblasti koja se dobijaju putem univerzitetskog obrazovanja i relevantnog treninga
- Poznavanje važećih zakona i uredbi
- Sposobnosti komuniciranja, planiranja rada i rukovođanja ekipom
- Istraživačke sposobnosti, analitičke sposobnosti i sposobnosti formulisanja preporuka i profesionalnih saveta
- Sposobnosti rada na kompjuterskim aplikacijama i programima (Word, Excel, Power Point, Access)

